



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr. 10/10 prot.

Vlorë më 22.04 2020

VENDIM

Nr.02, datë 16.04.2020

PËR

**LEJE PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes “Për përdorim të burimit ujor për prodhim hidroenergjie”, subjektit “Kurum International” Sh.a;
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Vjosë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FLAMUR MAMAJ

